

VENDIM
Nr. 639, datë 29.7.2020

**PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE,
OFICERË DHE NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, shkronja “b”, dhe 4, shkronja “b”, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 34, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, për çdo vit vjetërsi shërbimi, përfitojnë shtesë mbi pagë, në masën 1% për çdo vit, deri në 25 vjet. Llogaritja e shtesës për vjetërsi bëhet mbi pagën e gradës “Kryekapter”. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura, Policisë së Burgjeve dhe Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Gardës së Republikës, e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

2. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në shërbim, vetëm për efekt pagese, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe